

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.H., nga fsh. ... Komuna e Istogut, për shkak të veprës penale lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1 lidhur më nënpar.1.4 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit S.H., av. R.SH., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, P.nr.174/2018, të dt.28.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 19.12.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet- si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit S.H., av. R.SH., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, P.nr.174/2018, të dt.28.09.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, P.nr.174/2018, të dt.28.09.2018, është shpallur fajtor i akuzuari S.H., për shkak të veprës penale lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi më gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilin dënim është obliguar që ta paguaj në tri këste mujore, duke filluar nga muaji vijues nga data 05, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e shqiptuar më gjobë, sikurse në afatin e lartë cekur, atëherë i njëjti do të zëvendësohet më dënimin më burgim në kohëzgjatje prej 15 ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzet) euro.

Është obliguar i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej 20 (njëzet), paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuar H.H., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit S.H., av. R.SH., për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, sa i përket sanksionit penal, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i butë, apo i kushtëzuar.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtrësën PPA/II.nr.1248/2018, datë 05.12.2018, duke u sqaruar përkitazi më ankesën e ushtruar, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

-Ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit S.H., av. R.SH. nuk është e bazuar.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtësi i të akuzuarit S.H., av. R.SH., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij gjykata nuk i ka vlerësuar në masë të duhur të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në marrjen e vendimit, ngase gjykata nuk ka vlerësuar se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është i gjendjes së varfër ekonomike, se është i pa punësuar, baba i katër fëmijëve, mbajtës i familjes 6 antarëshe, ashtu që më dënimin e shqiptuar sikurse në dispozitivin e aktgjyimit, andaj në dënimin e shqiptuar gjendja ekonomike edhe më shumë do të vështirësohet.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjyimit, vjen në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë

për veprën penale e cila i vihet në barë, se ka pasur qëndrim korrekt në gjykatë, se është i gjendjes së varfër ekonomike, baba i katër fëmijëve dhe mbajtës i familjes 6 anëtarëshe, se ka shprehur keqardhje për veprën e kryer, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur, andaj, në prani të këtyre rrethanave, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore neni 74 dhe 75 të KPK, përkitazi me rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve dhe zbutjen e dënimeve, se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.1245/2018 të datës 19.12.2018

B. profesionale
Leonita Lajçi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Shqipe Qerimi